

TERMA REFERENCE

KOORDINATOR NË OPEN FORUME ME OBJEKTIV NDËRGJEGJËSIMIN E TË RINJVE MBI INTEGRITETIN E ZGJEDHJEVE DHE PROCESIN E DEKRIMINALIZIMIT ME NË FOKUS RRETHET KUKËS DHE LEZHË.

Pozicioni / Shërbim	Koordinator në Open Forume me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve mbi integritetin e zgjedhjeve dhe procesin e dekriminalizimit me në fokus rrethet Kukës dhe Lezhë.
Titulli i Projektit	“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”
Mbështetur:	Projekti financohet nga Ambasada Britanike në Shqipëri
Lloji i Kontrates :	Kontratë shërbimi – Moderator në Open Forume
Periudha e kontratës	Shkurt 2024
Ditë pune	2 ditë pune

Informacion i përgjithshëm për Projektin

- Projekti ka për qëllim të kontribuojë në parandalimin dhe shfaqjen e ndikimeve të panevojshme përmes angazhimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin, si dhe përmes informimit të një grupi të rëndësishëm të aktorëve dhe palëve të interesuara për të siguruar implementimin e drejtë dhe të lirë nga ndikimet e panevojshme në procesin zgjedhor.
- Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

Qëllimi i shërbimit

Në kuadër të implementimit të *“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”*, Instituti i Studimeve Politike kërkon koordinator në Open Forumet që do të organizohen në rrethet Kukës dhe Lezhë me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve mbi integritetin e zgjedhjeve dhe procesin e dekriminalizimit.

Koordinatori i kontraktuar nga ISP do të asistojë në organizimin e forumeve/debatet e hapura në kuadër të implementimit të projektit *“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”*.

Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit:

- Organizimi i debateve në qytetet e paracaktuara nga projektit;
- Përgatitja e bazës materiale dhe logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktiviteteve;
- Lidhja e kontakteve dhe koordinimi i vazhdueshëm mes stafit të projektit dhe lehtësuesit lokal;
- Të sigurojë se vendi dhe baza logjistike për realizimin e aktivitetit janë të përshtatshme dhe të vendosur një ditë para datës së zhvillimit të aktivitetit;
- Merr pjesë në takimet e projektit nëse kërkohet
- Të mundësojë dorëzimin e timesheet-eve, duke raportuar mbi orët e shërbimit të realizuara në përputhje me qëllimin e shërbimit të kërkuar, apo çdo dokument shoqërues që do të duhet për raportimin e shërbimit;
- Të jetë disponibël për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e kërkuar sipas afatit kohor të përcaktuar;
- Të mbrojë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të shërbimit.

Profili i moderatorit:

- Diplomuar në nivelin Master Profesional/Shkencor për Shkenca Politike, Sociale apo Administrim biznesi;
- Eksperienca të mëparshme bashkëpunimi me shoqërinë civile;

- Njohës i procedurave të prokurimit;

Aftësitë individuale:

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip dhe jo vetëm;
4. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afatet e vendosura.

Dokumentet e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dorëzojnë:

1. CV e detajuar
2. Ofertë Financiare e nënshkruar në GBP

Kostot dhe Pagesat

Kosto totale për sigurimin e këtij shërbimi për gjithë periudhën parashikohet të jetë **400 GBP** (katërqind) bruto. Mënyra e pagesës përcaktohet në Kontratën e Shërbimit pas punës së kryer.

Aplikimi duhet të dërgohen në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 05/02/2024 ora 16:00

1. **Në formë elektronike** në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com,
2. **Me postë** me zarf të mbyllur “*Kordinator në Open Forume Kukës dhe Lezhë. Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë
3. **Dorazi** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*Kordinator në Open Forume Kukës dhe Lezhë. Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

(Lutemi specifikoni qartë e-mail ose një nr. kontakti.)

Instituti i Studimeve Politike